

KONTRATË PUBLIKE KORNIZË

622-25-3175-1-1-1/C1663

KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë;
dhe

N.P.T. HAXHIJAH SH.P.K., Xhelal Hajda - Toni, Rahovec, (në vazhdim "Furnizuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizim me:

Bashkëfinancim me fermer në projektin Mekanizëm Bujqësor numër identifikues: **622-25-3175-1-1-1**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratë publike kornizë është të krijoj kushtet, duke përfshirë çmimet dhe rregullat e implementimit për dorëzimin e mallrave në vijim:

Bashkëfinancim me fermer në projektin Mekanizëm Bujqësor

Nr.	Grupi
1	Bashkëfinancim me fermer në projektin Mekanizëm Bujqësor

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontratë publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek furnizuesi, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim me sasitë e tyre përkatëse.

1.3 Sasitë e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë mallëratë përmendura në 1.1. .

1.4 Kontrata hynë në fuqi me 30. 06. 2025 dhe përfundon në datën 29. 06. 2026

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë _____ ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë **[Territori i Komunës së Prizrenit,**

2.3 Inkotermi I zbatueshëm do të jetë DDP¹ (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi

¹⁷ DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara –Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

4.1 Çmimet njësi të furnizimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Furnizuesi. Vlera totale indikative e kontratës është **378,950.00 € (treqind e shtatëdhjetë e tet mijë e nëntëqind e pesëdhjetë euro)**. Derivimi i lejuar nga vlera totale indikative është + - 30 % e vlerës së përgjithshme të kontratës bazë.

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës publike kornizë.

4.3 [shëno njerën]

[Çmimet për njësi janë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë kornizë] ose

[Çmimet për njësi të referuara në Nenin 4.1 të lartë përmendur i nënshtrohen ndryshimeve në vijim [shëno indeksin apo burimin tjetër për rregullimin e çmimeve].

4.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;
- (g) [shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.


6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.


6.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët ² in në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Furnizuesin.

¹⁸ Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga ana e tenderuesit në këtë tender.


Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Isa Osmankaj
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	28.06.2025
Vula:	

[Ne rast te kontratave me vlere te madhe]

Emri:	Z. Shaqir Totaj Kryetar
Pozita:	Zyrtar Kryesor Administrativ
Nënshkrimi:	
Data:	30.06
Vula:	

Për Furnizuesin

Emri:	Shkumbin Haxhijaha
Pozita:	Menaxher
Nënshkrimi:	
Data:	30.06.2025
Vula:	

KUSHTET E VEÇANTA
622-25-3175-1-1-1/C1663

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK	
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit		
Plani dinamik i realizimit		Furnizimet do të përfundojnë brenda 12 muaj kalendarik nga data e hyrjes në fuqi të kontratës	
Mbikqyrja dhe inspektimi			Mbikqyrës i drejtpërdrejt i menaxherit të kontratës do të jetë Bexhat Bytyqi Drejtor në Drejtorinë e Bujqësisë Menagjer i projektit: Jakup Kastrati IB në DB
Ligji zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.	
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe .	
Siguria e ekzekutimit	9.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është i 10 % vlerës së kontratës me vlefshmëri prej 13 muaj	
Sigurimi	10.1	Incotermi i aplikueshëm është DDP (Delivery Duty Paid).	
Programi i ekzekutimit	11	N/A	
Tatimet dhe marrëveshjet doganore	12.1	DDP (Delivery Duty Paid)	
Patentat dhe licencat	13.1	N/A	
Cilësia e furnizimeve	18.2	Autoriteti Kontraktues do të refuzojë çdo dergesë të materialit i cili deshton në përmbushjen e specifikimeve minimale të cilësisë të përcaktuara në specifikimin teknik.	
Inspektimi dhe	19.2	Inspektimi dhe testimi do të kryhen me rastin e dorëzimit dhe në	

testimi		përputhje me Nenin 19 të Kushteve të Përgjithshme në adresat e specifikuar në Nenin 2.2 të Kontratës.
Pagesa	20.1	Pagesa do të bëhet nga ana e Autoritetit Kontraktues për furnizimet e dorezuara vetëm në bazë të shumës së vlerës së një Urdhër Blerje të vlefshme të lëshuar nga autoriteti kontraktues.
Dorëzimi	21.3	Furnizuesi do t'i bartë të gjitha rreziqet që kanë të bëjnë me mallrat deri në pranimin në destinacion. Furnizimet duhet të pakëtohen në mënyrë që të parandalohet dëmtimi i tyre deri në destinacionin e tyre. Dërgesa: Dërgesat do të bëhet brenda [] ditëve pas marrjes së "urdhër blerjes" nga ana e Furnizuesit. Dorëzimi do të bëhet në një ditë pune dhe gjatë orarit të punës të Autoritetit kontraktues (e hënë - e premte, 8:00-16:00).
Obligimet e garancionit	24.1	[shëno periudhën e garancionit]
	24.5	N/A
Shërbimet pas shitjes	25.1	N/A
Zgjidhja e miqësore e mosmarrëveshjes	31.2	Neni 42 42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	32.1	43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë: a) ose vendim nga gjyqi; b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK. 43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

AUTORITETI KONTRAKTUES

KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT, Remzi Ademaj, -20000, PRIZREN,

Zyrtari përgjegjes i prokurimit:

Nr i Prokurimit: 622-25-3175-1-1-1

OPERATOR EKONOMIK:

Emri i kompanisë dhe adresa e plote: N.P.T. HAXHIJAH SH.P.K., Xhelal Hajda - Toni, 162, Rahovec, Kosovë

E-mail: info@haxhijaha.com

Personi kontaktues: Shkumbin Haxhijaha

Telefoni: 045111307

Faxi:

Numri fiskal: 810396772

Grup i operatorëve ekonomik (nëse aplikohet):

FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: 622-25-3175-1-1-1

Titulli i kontratës: Bashkëfinancim me fermer në projektin Mekanizëm Bujqësor

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.
2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

1 Bashkëfinancim me fermer në projektin Mekanizëm Bujqësor

3. Çmimi total i tenderit është:

378,950.00 EUR

Dhe në fjalë [shëno çmimin e tenderit në fjalë Euro]

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: **120** nga data finale për dorëzim të tenderëve.

5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës

6. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet] si partner në konsorcium të udhëhequr nga [shëno emrin e udhëheqësit]. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës.

7. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK

8. Theksojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që e rezervon të drejtën për të dhënë vetëm një pjesë të kontratës. Ai nuk do të shkaktojë detyrime ndaj

PARAMASAT PËR FURNIZIM ME MEKANIZËM BUJQËSORË
DREJTORIA PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL.

Nr.	Emërtimi i punëve	Njësia	Sasia	Çmimi/ njësi (€)	Totali (€)
1	Motokultivator 4.4 Kë me frezë dhe kosë	Copë	100	€ 1,100.00	€ 110,000.00
2	Motokultivator 7.5 Kë me frezë	copë	5	€ 3,550.00	€ 17,750.00
3	Pjatore 20 disqe	Copë	40	€ 1,200.00	€ 48,000.00
4	Trina 3 kraheshe	copë	90	€ 530.00	€ 47,700.00
5	Mbjellëse misri pneumatike 4 rend.	Copë	5	€ 5,400.00	€ 27,000.00
6	Pllugj 2 rende	cop	90	€ 850.00	€ 76,500.00
7	Atomizer 400l	cop	20	€ 1,450.00	€ 29,000.00
8	Mbjellëse gruri 16 rendëshe	Copë	5	€ 4,600.00	€ 23,000.00
				Gjithsej:	€ 378,950.00





0063273

NUMRI I POLICËS	063273
SIGURUESI	K.S. SCARDIAN J.S.C Adresa: Rr. Perandori Justinian 3, 10000 Pristine, Kosovo
AGJENTI	Mykerem Refiku Adresa: Rr. De Rada A2 nr. 19
I SIGURUARI	N.P.T`HAXHIJAH`SH.P.K Adresa: RR-XHELAL HAJDA - RAHOVEC
NUMRI I BIZNESIT	810396772
NUMRI FISKAL	810396772
QËLLIMI I SIGURIMIT	Garanci e Kontratës
PËRFITUESI	KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT
TITULLI I KONTRATËS	BASHKEFINANCIM ME FERMER NE PROJEKTIN MEKANIZEM BUJQESOR
NUMRI I IDENTIFIKIMIT-PROKURIMIT	622-25-3175-1-1-1
TERRITORI I MBULIMIT	Republika e Kosovës
PERIUDHA E SIGURIMIT	394 ditë
SHUMA E SIGURUAR	37,895.00 EURO
Nga:	26-06-2025
Deri:	25-07-2026
PRIMI I SIGURIMIT	738.95
TVSH 18 %	133.01
PRIMI +TVSH 18%	871.96
DATA E LËSHIMIT	2025-06-25 14:00:16

VËREJTJE:

Polica e sigurimit të Garancive është krijuar në bazë të Ligjit Mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve Nr.04/L-077, të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me datë 10.05.2012, gjithashtu sipas Rregullave dhe Rregulloreve të Aprovuara nga Banka Qendore e Republikës së Kosovës. Pjesë përbërëse e kësaj police janë Kushtet e përgjithshme, pyetësori i plotësuar dhe të nënshkruar dhe çfarëdo dokumenti tjetër i bashkangjitur me me policën e sigurimit.

Kjo policë sigurimi vërtetohet lidhur e kontratës, dhe lëshohet nga Siguruesi në bazë të deklarimeve dhe kërkesave të bëra nga i Siguruari/përfaqësuesi i të siguruarit, i cili është përgjegjës lidhur me saktësinë dhe vërtetësinë e deklarimeve të bëra prej tij.

Unë i Siguruari/ përfaqësuesi i të siguruarit, deklaroj se i kam lexuar me vëmendje dhe i kam kuptuar kushtet e kontratës së sigurimit, deklaroj se pajtohem me to, si dhe me të dhënat dhe përcaktimet e kësaj police sigurimi, dhe po nënshkruaj konform vullnetit tim të lirë, e të plotë.

I SIGURUARI

(emri, mbiemri, nënshkrimi)



SCARDIAN

(emri, mbiemri, nënshkrimi)

KUSHTET E PËRGJITHSHME TE SIGURIMIT TË GARANCIVE

Neni 1

Scardian Sigurime (Siguruesi) ka lëshuar për të Siguruarin (debitori kryesor) me kërkesën e këtij të fundit, certifikatën e garancisë dhe policën e sigurimit, në mbulim të përgjegjësisë së saj (brenda periudhës/vlefshmërisë të sigurimit), ndaj "Përfituesit" (autoriteti kontraktor) deri në shumën/vlerën e siguruar.

Neni 2

I Siguruarit (debitori kryesor) dhe Përfaqësuesi i tij (debitori solidar) pranon përbajtjen e Certifikatës së Garancisë dhe Policës së Sigurimit, dhe detyrohet të paguaj primin përkatës të sigurimit si dhe të përdorë Certifikatën e Garancisë dhe Policën e Sigurimit për qëllimin e mirë për të cilat ato lëshohen, duke ju përbajtur moralisht dhe ligjërisht të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga përdorimi i tyre.

Neni 3

Objekti i Certifikatës së Garancisë dhe Policës së Sigurimit është sigurimi i detyrimit që mund të lind në të ardhmen nga konfiskimi i Garancisë që Siguruesi ka lëshuar për të Siguruarin (debitori kryesor) dhe në favor të Personave të tretë, siç dhe përcaktohet në Certifikatën e Garancisë dhe Policën e Sigurimit, brenda periudhës/vlefshmërisë të sigurimit.

Neni 4

Scardian Sigurime ka të drejtën e rimbursimit nga Debitori Kryesor dhe/ose Debitori Solidar të çdo shume brenda vlerës totale të siguruar, plus interesa, kamat vonesa apo çdo shpenzim për rimbursimin e çdo shume që Siguruesi bëhet përgjegjës të paguaj, në përputhje me detyrimet e parashikuara në Certifikatën e Garancisë dhe Policës së Sigurimit.

Neni 5

Në rast se Përfituesi (autoriteti kontraktor) i përcaktuar në Certifikatën e Garancisë dhe Policën e Sigurimit, paraqet kërkesë për "konfiskimin e garancisë", Debitori Kryesor dhe/ose Debitori Solidar brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e kërkesës do t'i paguajnë Siguruesit, ose do të vendosin si kesh kolateral (para) në emër të tij, çdo shumë që Siguruesi bëhet përgjegjës të paguajë sipas përcaktimit në nenin 3 (tre) dhe 4 (katër) të kësaj kontrate, pavarësisht nëse Siguruesi, ka kryer apo jo pagesë sipas detyrimeve të parashikuara në Certifikatën e Garancisë dhe Policën e Sigurimit.

Neni 6

Kërkesa e Përfituesit (autoriteti kontraktor) për "konfiskimin e garancisë" do të jetë e vlefshme kur shoqërohet nga:

- (a) Certifikata e Garancisë dhe Polica e Sigurimit;
- (b) Kopja e vendimit të Gjykatës, nëse ka të tillë;
- (c) Njoftimin/komunikimin paraprak (me shkrim) me Debitorin Kryesor, në lidhje me moskryerjen e detyrimeve nga ana e tij dhe anulimin e marrëdhënies kontraktuale;
- (d) Dokumentacionin e plotë (prova), që vërteton mosplotësimin e detyrimeve nga Debitori Kryesor;

Neni 7

Siguruesi do të shtyjë kohën e pagesës, për aq kohë sa ekzistojnë dyshime mbi të drejtën e Përfituesit për të marrë pagesën, ose/dhe nëse janë filluar hetime penale në lidhje me ngjarjen e sigurimit kundër të Përfituesit, Debitorit Kryesor dhe/ose Debitori Solidar, ose/dhe për aq kohë sa i Përfituesi nuk paraqet dhe plotëson dokumentacion e kërkuar nga Siguruesi. Barra e shpenzimeve për sigurimin e provave, që vërtetojnë humbjen dhe mosplotësimin e detyrimeve nga Debitori Kryesor, bie mbi Përfituesin.

Neni 8

Scardian Sigurime i lind e drejta që t'i drejtohet Debitorit Kryesor dhe/ose Debitorit Solidar, me të gjitha mjetet ligjore, për të bërë rimbursimin e të gjitha shpenzimeve të kryera në funksion të plotësimit të detyrimeve ndaj Përfituesit/Autoritetit Kontraktor (cedimi i të drejtave nga Përfituesi tek Siguruesi).

Neni 9

Të gjitha detyrimet e çfarëdo natyre që Siguruesi duhet të përballojë për kthimin e shumës së garancisë së paguar, janë në ngarkim të Debitorit Kryesor dhe/ose Debitorit Solidar.

Neni 10

I Siguruarit (debitori kryesor) dhe "Përfituesit" (autoriteti kontraktor) njoftojnë Siguruesin në rast të ndryshimeve eventuale të kontratës midis tyre. Në këtë rast Certifikata e Garancisë dhe Polica e Sigurimit konsiderohet e zgjidhur dhe Siguruesi çlirohet nga detyrimi për të dëmshpërbyer.

Neni 11

Debitori Kryesor dhe/ose Debitori Solidar bien dakort që në rast kërkesë nga Siguruesi do të mundësojnë vendosjen e barrave siguruese mbi pasuri të luajtshme dhe/ose barreve hipotekore mbi pasuri të paluajtshme pronë të tyre (kontrata mbi hipotekën e lidhur midis palëve kontraktuese).

Neni 12

Kjo Kontratë do të konsiderohet pjesë integrale e Certifikatës së Garancisë dhe e Policës së Sigurimit.

Neni 13

Kjo Kontratë, në kuptim të përmbushjes së detyrimeve nga palët kontraktuese, përbën titull ekzekutiv në bazë të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve. Në rast se Debitori Kryesor dhe/ose Debitori Solidar nuk respekton detyrimet e përcaktuara në këtë Kontratë, Siguruesi në bazë të dispozitave ligjore të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, ka të drejtë t'i drejtohet menjëherë Gjykatës Ekonomike të Prishtinës, për lëshimin e Urdhër Ekzekutimit të kësaj Kontrate.

Neni 14

Certifikata e Garancisë është e vlefshme vetëm kur është e shoqëruar me Policën e Sigurimit të Garancisë, mbi bazën e të cilës ajo është lëshuar.

Neni 15

I Siguruarit (debitori kryesor) dhe Përfaqësuesi i tij (debitori solidar) janë të detyruar t'i dorëzojnë "Përfituesit" (autoriteti kontraktor) Certifikatën e Garancisë së bashku me Policën e Sigurimit. Në rast se "Përfituesi" (autoriteti kontraktor), brenda 7 (shtatë) ditëve, nga data e lëshimit, nuk i kundërshton Certifikatën e Garancisë dhe Policën e Sigurimit, atëherë nga Siguruesi do të konsiderohen si të pranuar nga Përfituesi (autoriteti kontraktor) dhe nuk mund të kundërshtohen më prej tij.

Nëse Debitori Kryesor apo/dhe Debitori Solidar, me qëllim apo për neglizhencë, nuk zbaton tërësisht apo pjesërisht detyrimet e mësipërme, Siguruesi çlirohet nga përmbushja e detyrimeve të tij

Neni 16

Për çfarëdo nuk është përcaktuar shprehimisht në këtë Kontratë do të zbatohen dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Neni 17

Në rast se ndonjë apo më shumë nga dispozitat e kësaj Kontrate dhe akteve të tjera të cilave kjo Kontratë i referohet shpallen apo mund të konsiderohen të pavlefshme, të paligjshme apo të pazbatueshme, vlefshmëria, ligjshmëria apo zbatueshmëria e dispozitave që mbeten nuk do të ndikohet. Palët në mirëbesim do të negociojnë për të zëvendësuar dispozitat e kontestueshme me dispozitat të vlefshme me efekte riparuese të përafërta me qëllimin e palëve të shprehur sipas kësaj Kontrate.

Neni 18

Ndryshime eventuale të kësaj Kontrate mund të bëhen me Aneks-Kontratë, të nënshkruar nga të dyja palët.

Neni 19

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis palëve si rezultat i kësaj Kontrate zgjidhen me mirëkuptim, në rast të kundërt do të jenë kompetencë e Gjykatës Ekonomike të Prishtinës.

Neni 20

I Siguruarit (debitori kryesor) dhe Përfaqësuesi i tij (debitori solidar) deklarojnë me përgjegjësi të plotë ligjore se në rast të mospërmbushjes së obligimeve nga ana e tyre ndaj Përfituesit (autoriteti kontraktor), dhe kërkesës të këtij të fundit për "konfiskimin e garancisë", atëherë Scardian Sigurime, ka autorizim të plotëfuqishëm, për të bërë rimbursimin e plotë të çdo shumë që bëhen përgjegjës të paguajë, nga "llogaria bankare" e Debitorit Kryesor apo Debitorit Solidar.

Neni 21

Qëllimi ynë është që ta bëjmë punën drejtë që nga fillimi dhe gjithmonë. Në rast se ne bëjmë ndonjë gabim, ne do të mundohemi që ta rregullojmë shumë shpejt. Ne do tju konfirmojmë gjithmonë pranimin e ankesës brenda pesë ditëve të punës dhe do ta bëjmë më të mirën tonë që ta zgjidhim problemin brenda katër javëve. Në rast se ne nuk mundemi, do tju njoftojmë kur mund të pritet përgjigja.

Në rast se ju keni ankesë ju lutemi të kontaktoni në:

Kompania e Sigurimeve SCARDIAN J.S.C.
Rr. Perandori Justinian Nr.3
10000, Prishtinë
Republika e Kosovës
Numri i telefonit: 00381 38 777 444
Fax: 00381 38 777 444
Email: scardianankesa@scardian.com



Pjesë përbërëse e policës: 063273

Për: KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT
(në vazhdim "Autoriteti Kontraktues")

Në emër të: N.P.T`HAXHIJAH`SH.P.K, RR-XHELAL HAJDA - RAHOVEC
(në vazhdim "tenderuesi")

VËREJTJE:

Titulli i aktivitetit të prokurimit: BASHKEFINANCIM ME FERMER NE PROJEKTIN MEKANIZEM BUJQESOR

Numri i prokurimit: 622-25-3175-1-1-1

SIGURIA E KONTRATËS

Garancion me kërkesë të parë

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit , me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitojë sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e tenderit;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t'i japim operatorit ekonomik këtë siguri:

ANDAJ NE të poshtë nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një total prej: **37,895.00 EURO (TRIDHJETE E SHTATE MIJE E TETEQIND E NENTDHEJTE E PESE)** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mos përmbushja e njërit nga kushtet në vijim:


(a) Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substancionale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë; dhe

(b) Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe /ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej: **37,895.00 EURO** siç është lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejtë që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin "e pranimit".

Kjo siguri vlen 394 ditë
Data e fillimit: 26-06-2025

Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit:


SCARDIAN Sigurime
Rr. Perandori Justinian Nr.3
10000 Prishtinë
Kosovë
2025-06-25 14:00:16

